



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbal i mbajtur më 29 prill 2016, në mbledhjen e XXVIII-të (njëzetetë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10:05 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesuesi i Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe, z. Agim Veliu Kryetar i Komunës, z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës, drejtorë të Drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, përshëndeti të pranishmit, theksoi, konsideroj se thirrja dhe materiali për këtë mbledhje u është dërguar me kohë, Gjithashtu konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur një ditë më parë u janë shpërndarë para fillimit të kësaj mbledhjeje ku mund të vëreni se në atë mbledhje i është rekomanduar Kuvendit përfshirja në rend dite edhe një pikë shtesë, andaj mund të fillojmë me punë.

z. Haki Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së kemi diskutuar dhe kemi ardhur në përfundim se me planin e punës që është miratuar në këtë Kuvend është paraparë që në këtë muaj ta kemi një informatë rreth subvencionimit të sportit në Komunën e Podujevës gjë që këtë pikë nuk e kemi dhe shpresoj që në seancën e radhës ta kemi atë. Për këtë mbledhje propozoj që ta kemi një informatë nga Drejtoria e Arsimit lidhur me ekskursionet e nxënësve të klasave të X, XI dhe XII-ta që po bëhen në mënyrë vullnetare por megjithatë ka dikush ndikime. Në shkollën ku unë punoj, sot një numër i prindërve të nxënësve e kanë ngritur këtë çështje dhe janë tejet të shqetësuar për mënyrën e organizimit të ekskursionit me apo leje të Drejtorisë së Arsimit, konsideroj se mundësit për ndalime janë të shumta sepse kanë mundësi Drejtoria e Inspeksionit mandej edhe Policia e Kosovës të ndër marrin masa, andaj mendoj se kjo lojë që po bëhet me nxënës nuk është mirë të ndodh. Është mirë që prezent këtu është edhe Kryetari i Komunës i cili mund të ndalojë këto gjëra nëse nuk janë me leje të Drejtorisë së Arsimit. Unë punoj në Arsim dhe forma e organizimit të ekskursioneve me klasa të nënta është krejt në rregull ndërsa konsideroj se forma e organizimit të shkollave të mesme është tejet shqetësuese.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nuk e shoh të arsyeshme që propozimi i parafolës të përfshihet në rendin e propozuar të ditës për këtë mbledhje por mund të përfshihet vetëm si kërkesë apo pyetje në pikën të ndryshme të rendit të ditës.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, në seancën e kaluar në këtë Kuvend ne kemi marrë një vendim për një temë të cilën unë e ngrita gjatë mbledhjes, dhe unë nuk pash ndonjë informatë që është respektuar ai vendim, gjegjësisht a është respektuar nga shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit dhe a ju jeni drejtuar organeve kompetente për shqetësimet e ngritura nga ne dhe për vendimin që e morëm, pra vetëm desha ta dija se çka është ndërmarr në këtë drejtim.

z.MehmetGashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, fillimisht e hedh në votim kërkesën – propozimin e z.HakiRudarit që në rendin e propozuar të ditës të përfshihet edhe pika shtesë, Informatë nga Drejtoria e Arsimit lidhur me organizimin e ekskursioneve nga nxënësit e shkollave të mesme.

Pas votimit u konstatua se me 14 vota për dhe 18 vota kundër nuk u miratua kërkesa - propozimi i z.HakiRudarit.

Kryesuesi i Kuvendit e hedh në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit u konstatua se me 31 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe pikën shtesë sipas rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht në kuadër të pikës së 7 të rendit të ditës të përfshihet edhe pika;

- **Propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së “HibPetrol” sh.p.k. me pronar Ibrahim Bucaliu nga Ferizaj.**

2. Raporti financiar për periudhën janar – mars 2016

z.IsufLatifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, në fjalën hyrëse paraqiti përmbajtjen e dokumentit duke pasqyruar të gjitha shpenzimet dhe të hyrat e Komunës në kode dhe programe të caktuara ekonomike për këtë periudhë si dhe duke bërë krahasime me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ku ceket se ka një rritje të shpenzimeve prej 8.68%.

Gjithashtu drejtori paraqiti edhe të hyrat vetanake për këtë periudhë ku krahasuar me periudhën e vitit të kaluar ka rritje prej 9.55%, dhe shtoi, është inkurajuese inkasimi i tatimit në pronëdhe ju njoftoj se që nga hyrja në fuqi e ligjit për faljen e borxheve e deri në fund të muajit mars, të drejtën që u ja jap ligji, e kanë shfrytëzuar 1013 tatimpagues ku borxhi total i tyre ka qenë 961,847.63€, kurse janë paguar 129,243.69€ dhe nga kjo ngarkesë, sipas ligjit janë falur 832,603.94€, e që mendoj se është një trend i mirë, por përkundër kësaj mendoj se mbetet shumë për tu bërë në periudhën vijuese në mënyrë qëinkasimi i të hyrave të jetë në nivel të kënaqshëm dhe kjo mund të arrihet me një punë të përbashkët duke bërë apel qytetarëve dhe bizneseve që kanë obligime nda Komunës. Krejt në fund mund të konstatoj se ky raport jep një pasqyrë të qartë të të hyrave dhe të dalave të Komunës për periudhën përkatëse.

z.FidanRekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përshëndesim këtë raport i cili pasqyron të gjitha të hyrat dhe të dalat e

Komunës së Podujevës për periudhën përkatëse kohore. Vlen të përrshëndetet Ekzekutivi i Komunës i cili në vazhdimësi është duke i'u përmbajtur obligimeve ligjore që janë në kuadër të raporteve financiare të Komunës.

z.RafetLlapashtica, theksoi, ne në mbledhjen e KPF-së i kemi rekomanduar Kuvendit shqyrtimin e raportit financiar janar – mars 2016, dhe është e vërtetë se drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF) ka pasqyruar shpenzimet e Komunës për këtë tremujor, mirëpo duke u bazuar në të dhënat aktuale që janë tregun se ka munguar dinamizmi i investimeve kapitale ku për tre muaj kemi vetëm 47,000€ investime kapitale kurse shpenzimet tjera obligative arrijnë shumën afër 3 milion euro. Ne mendojmë se për këtë periudhë si pagesa të panevojshme dhe shumë e madhe e shpenzimeve për buxhetin e Komunës së Podujevës janë shpenzimet e telefonisë mobile afër 4,800.00€, ku me një përlllogaritje reale nëse e kalkulojmë me 0.04 cent një minutë për telefoni mobile apo 0.02 cent për telefoni fikse, i bie që zyrtarët komunal kanë qëndruar në telefon rreth tri orë në ditë pandërprerë në telefon, unë mendoj që secila Drejtori apo secili zyrtarë i cili ka bërë këto shpenzime është dashur të mendoj se nga 8 orë punë dalin që 3 orë ka qëndruar në telefon, pra drejtori i DBF i ka bërë këto pagesa mirëpo mendoj se me këtë ritëm deri në fund të vitit këto shpenzime mund të arrijnë deri në 100,000.00€. Çështja tjetër është se vazhdimisht në çdo raport financiar figurojnë pagesa të dhunshme sipas vendimeve të Gjykatave apo rregullave ligjore të Ministrisë së Financave (MF) që mendojmë se shuma prej 3.5% e dënimit që e jep Gjykata në mënyrë të dhunshme, është e panevojshme që merret nga buxheti i Komunës sepse ato mjete janë obligative dhe duhet të paguhen e që për tre muaj arrijnë shifrën rreth 14,000.00€ vetëm pagesa të dhunshme, kurse sipas ligjit të Thesarit – Ministria e Financave, jemi në dijeni, por edhe në trajnimin që kemi qenë në Bogë, kemi marrë vendim të gjitha Grupet e këshilltarëve që të sillen në KPF të gjitha faturat e papaguar në mënyrë që ne ta kemi një pasqyrë të qartë ndërsa i nderuari Kryesues i Kuvendit kjo nuk ka ndodhur e që ka qenë edhe qëndrim i LDK kjo çështje, ndërsa ende nuk jemi në dijeni se sa fatura të papaguar kemi qoftë të vitit të kaluar qoftë në këtë vit. Çështja tjetër është që në çdo tremujor raportohen pagesa për shërbime këshillëdhënëse dhe intelektuale, unë nuk e besoj që me një shpenzim prej 47,000.00€ për investime kapitale është bërë ndonjë këshillë e madhe, prandaj mendoj se është pagesë e panevojshme sepse kushdo qoftë në qeverisje nuk ka të drejtë të paguaj pagesa për këtë shërbim, dhe unë kam pyetje konkrete për drejtorin e DBF se përçarë shërbimi këshillëdhënëse dhe intelektual është bërë kjo pagesë rreth 930,00€, për cilin projekt dhe për çka është paguar kjo faturë.

z.HakiRudari, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje e kemi shqyrtuar këtë raport dhe mendojmë se nuk është përmbushje e obligimeve ligjore vetëm sjellja në Kuvend e raportit financiar por obligim ligjor i Ekzekutivit të Komunës është edhe menaxhimi më i mirë dhe më shumë investime sepse për atë arsye është edhe buxheti komunal prej më shumë se 18 milion euro ku prej tyre më shumë se 5 milion euro për investime kapitale të kemi investime prej 47,263.00€, mendoj se nuk është në rregull për arsye se kërkesat e qytetarëve janë të shumta, duke filluar nga infrastruktura, pastaj arsimi, shëndetësia, bujqësia, gjelbërimi, mbrojtja e ambientit, sporti, kultura e të tjera, kurse mendoj se një investim kaq i vogël në këtë tre muajorë tregon se qeveria komunale duhet të analizoj mirë dhe njëherë e përgjithmonë të sjell në Kuvend një plan program në mënyrë që të kemi të detajuar dhe mendoj se mungesa e tillë bënë që të kemi një investim kaq të vogël, nga 5 milion euro për investime kapitale, kemi vetëm 47,263.00€, mendoj

se nuk është për mburrje dhe krenari. Megjithatë me këtë shpenzim prej 3,318,646.00€, në rast se hymë në detaje dhe shohim shpenzimet kemi rritje nëpër disa kode, dhe atë, kemi rritje prej 59.57% të shpenzimeve të telefonisë mobile, pastaj 158.30% kemi rritje për shërbime kontraktuese tjera ku prej 24,300.00€ sa i shihet në periudhën e njëjtë të vitit 2015 në këtë tremujor të vitit 2016 janë 62,768.00€ e që mendoj se është një rritje vërtetë e enorme, mandej kemi rritje prej 30% për furnizim me ushqim dhe pije, pastaj furnizime pastrimi kemi rritje të shpenzimeve prej 1,041.00€ në tremujorin e parë të vitit 2015, në këtë tremujor të vitit 2016 kemi 12,300.00€ e që mendoj se është një rritje vërtetë e madhe dhe nuk specifikohet se për furnizime pastrimi bëhet fjalë, po ashtu rritje prej 39.85% kemi për naftë për ngrohje qendrore kunga 15,779.00€ kemi 22,067.00€ dhe duke qenë në dijeni dhe duke pasur parasysh se në këtë vit ka qenë një çmim i lirë i naftës kurse ne kemi rritje të shpenzimeve e që mendoj se nuk është në rregull, po ashtu rritje prej 27% të shpenzimeve kemi edhe për dru, gjithashtu çështje tjetër e cila po përsëritet vazhdimisht është edhe shpenzimet sipas vendimeve të Gjykatave ku vazhdimisht kemi ndëshkime dhe mendoj se njëherë e përgjithmonë është mirë të ndalohen këto shpenzime dhe të dihet arsyeja e këtyre vendimeve se a është si pasojë e një menaxhimi jo të mirë të qeverisjes komunale apo si po ndodh të kemi vendime apo gjykojta kaq të madha nga Gjykatat. Sa i përket të hyrave vetanake kemi rritje të shpenzimeve prej 20.90% për punëtorë me kontratë dhe kjo çështje si duket në Komunën tonë nuk ka të ndalur, dhe në vend që në këtë vit të kemi zvogëlim të shpenzimeve për këtë çështje ne kemi rritje, vërejtje që vazhdimisht është bërë edhe Auditori i Përgjithshëm, kurse kjo përsëritet prap dhe madje kemi rritje. Për shërbime këshillëdhënëse intelektuale nga të hyrat vetanake kemi 6,590.00€ dhe nuk specifikohet për çfarë bëhet fjalë. Megjithatë te të hyrat vetanake kemi rritje të inkasimit, për ne mbeten shqetësueset të hyrat nga qiraja apo shfrytëzimi i pronës komunale ku nga 80,000.00€ të planifikuara në vitin 2016 deri tani janë inkasuar 7,328.00€ apo vetëm 9% ose 70% më pak se në tremujorin e vitit të kaluar, dhe duke u bazuar në këtë mendoj se për çështje të tilla duhet të ketë më shumë vetëdije dhe së paku shfrytëzimi i pronës komunale të jetë në mënyrë më të rregullt. Në fund mund të themi se një investim prej 47,263.00€ tregon se nuk është në rregull kur kemi parasysh kërkesat e shumta të qytetarëve.

z.Flakron Gashi, theksoi, nuk dëshiroj të ndalem në hollësira tjera të cilat tani veç i pasqyruan kolegët para folës, mirëpo pasqyra që jep ky raport financiar i Komunës së Podujevës për tremujorin e parë të vitit 2016, del që Komuna e Podujevës nga gjithsejtë 3,318,646.00€ të shpenzuara, vetëm 77,798.00€ janë shpenzuar për subvencione dhe transfere, pra ky është një parametër që tregon qartë orientimin e qeverisjes komunale se sa është e aftë të jetë konsumuese e mjeteve pa ndonjë indikator të zhvillimit lokal. Është shumë e thjeshtë të zëbërthehen shpenzimet tremujore të cilat vejnë në pah dobësinë, mos efikasitetin dhe menaxhimin e dobët me resurset financiare kundrejt nevojave dhe interesave të qytetarëve, dhe nuk ka se si të jetë ndryshe ku për tre muaj harxhohen në emër të shpenzimeve për zyrë mbi 22,000.00€, për furnizime pastrimi 12,300.00€, ndërsa për furnizime mjekësore 10,618.00€, unë mendoj se kjo është absurde përkundër asaj që Komuna e Podujevës ka të nënshkruar një kontratë kornizë për furnizim me barna me operatorin Madekos në vlerë 131,976.00€, andaj shtrohet pyetja, si është e mundur që Komuna e Podujevës të shpenzojë më shumë për furnizime pastrimi, që sigurisht duhet të jetë domestos dhe letër tualeti ose sapun të duarve, se sa për furnizime mjekësore për nevojat e mbi 89 mijë banorëve rezident të

Komunës së Podujevës, pra kësi soji punëtorët shëndetësorë në Podujevë janë të sfiduar me mundësinë për t'iu shërbyer qytetarëve në kujdesin primar shëndetësorë dhe në këto rrethana unë mendoj se duhet të vlerësohet puna e tyre, ndërsa çështja mbetet tek kujdesi dhe interesimi i Komunës karshi kërkesave të shëndetësisë primare.

z.FaikMuçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit (DSHPMSH), theksoi, dëshiroj të jap disa sqarime sa i përket segmentit të shpenzimeve ose investimeve kapitale të DSHPMS. Është shumë jo e madhe e shpenzuar në këtë tremujorë të parë të viti ngase disa punëapo investime kapitale nuk mund të kryhen nëkëtë periudhë, si dhe arsyeja tjetër është se nuk kemi borxhe të mëdha nga viti i kaluar andaj edhe shuma e shpenzimeve deri në këtë periudhëështë e vogël. Gjithashtu besoj që edhe Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit nuk ka pasur mundësi që në këta tre muaj të parë të ketë dinamikë më të madhe të asfaltimit të rrugëve ose investimeve dhe projekteve tjera të ndryshme, mirëpo unë ju them se sipas dinamikës së prokurimit dhe buxhetit që kemi në dispozicion ne si Komunë mbi 70% të projekteve ose janë duke u punuar ose janë në procedura të prokurimit apo para nënshkrimit të kontratës, që do të thotë se dinamika e shpenzimeve është në bazë të planifikimit. Ka punë të cilat kanë filluar ose kanë përfunduar në muajin mars dhe pagesat kryesisht janë bërë në muajin prilldhe vazhdojmë sipas trendit të planifikuar. Sa i përket shpenzimeve për mallra dhe shërbimeve ato janë shpenzime të përhershme prandaj janë edhe më të ngritura dhe normale për këtë periudhë dhe sigurisht se në periudhat tjera ato shpenzime zvogëlohen ndërsa rriten shpenzimet për investime kapitale.

z.IsufLatifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, unë sigurisht edhe në fjalën hyrëse e potencova se rreth 8% shpenzimetdhe rreth 10% tëtë hyrave janë të rritura në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Të gjithë ne jemi në dijeni se shpenzime fikse nuk ka, nuk do të thotëqë shuma e njëjtë qëështë shpenzuar në vitin paraprak të shpenzohet edhe në vitin vijues, por mund të shpenzohen shuma tjera të përafërta varësisht nevojave që ka Komuna, dhe është shumë mirë qëtabelë janë paraqitur rritjet dhe zvogëlimet e shpenzimeve. Më erdhi mirë që nga disa parafolës u cituan vetëm kodet ku ka rritje të shpenzimeve por nuk u përmenden ato shpenzime ku ka pasur zvogëlim e që në të kaluarën ka pas mjaft vërejtje, dhe që askush nuk i përmendi si diçka pozitive, shembull, për karburante për vetura ka 33% shpenzime më të vogla se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, pastaj shumë herë ka pas diskutime dhe mospajtime rreth shpenzimeve për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve, ndërsa tani kemi 44.92% zvogëlim të shpenzimeve në këtë kod, për mirëmbajtje të shkollave kemi 31% zvogëlim të shpenzimeve. Gjithashtu ne të gjithë duhet të jemi në dijeni se deri në fund të muajin janar nuk fillon shpenzimi i buxhetit ndërsa në këtë periudhë për shpenzime janë muajt shkurt dhe mars, po ashtu në këtë raport janë të pasqyruara edhe shpenzimet të cilat kanë ndodh në majin dhjetor të vitit 2015 pa përjashtuar ndonjë faturë të muajit nëntor të papaguar kështu që tani janë të reflektuara në këtë raport për shkak se sistemi i kontabilitetit në Republikën e Kosovës është me para të gatshme, pra paraqitet shpenzimi vetëm atëherë kur e paguan si dhe paraqitet e hyra vetëm atëherë kur dikush ka paguar - inkasuar të hollat në llogari të Komunës. Sa i përket faturave të papaguara, në raportin financiar për vitin paraprak që ka qenë në seancën e kaluar është paraqitur shuma e borxheve të papaguara në vitin 2015 në kategoritë mallra dhe shërbime, dhe kategorinë e investimeve kapitale. Sa i përket një shpenzimi i cili është në listën e kodeve ekonomike me emërtim, shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, është

shpenzim i cili ka ndodhur nënjë aktivitet të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit ku janë harxhuar 130.00€ për një shërbim i cili nuk ka pasur kod më adekuat i cili iu ka përshtatur atyre aktivitetëve që janë kryer në atë Drejtori, prandaj edhe është futur në atë kod me emrin shërbime tëndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse, kështu që për këtë shpenzim ekziston lënda dhe mund të sqarohemi me secilin prej juve.

z.MehmetGashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e përgëzoj Ekzekutivin e Komunës për raportim periodik të rregullt financiar. Në bazë të përvojës që kam në Ekzekutiv nga vitet e kaluara, shuma për investime kapitale në këtë tremujorë të parë të vitit është normale sepse janë kushtet atmosferike ato që i pamundësojnë ato investime, por edhe procedurat e prokurimit janë me afate të caktuara dhe mund të ndikojnë në këtëçështje, mirëpo shpenzimet përkatësisht investimet mund të rriten pas periudhës gjashtëmujore të vitit gjë të cila është dëshmuar edhe në vitin e kaluar.

Edhe pse me ligj decidivisht nuk kërkohet votim për raporte të tilla, unë ashtu sikurse praktikave të mëparshme e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se me 18 vota për, 13 vota kundër dhe 1 votë e përmbajtur u miratua raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar-mars 2016

3. Propozimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal – SZHEL për periudhën 2016 – 2018

➤ Raporti për zbatimin e diskutimit publik

z.AvniFetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe i autorizuar për ushtrimin e të gjitha kompetencave të drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, e paraqiti fjalën hyrëse rreth Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2016-2018 përkatësisht njoftoj këshilltarët e Kuvendit të Komunës për mbajtjen e diskutimeve publike me qytetarë, nxënës dhe komunitetin e biznesit, ndër të tjera theksoi, me vendimin e Kuvendit të Komunës së Podujevës të datës 29 janar 2016 është vënë në diskutim publik propozim Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2016 – 2018 ku me qëllim të zbatimit të këtij Vendimi dhe me qëllim të marrjes sa më shumë të opinionëve, rekomandimeve dhe propozimeve për pasurimin e dokumentit në fjalë, ne kemi mbajtur 5 takime radhazi duke filluar me debatin me qytetarë në këtë sallë të Kuvendit të Komunës, pastaj debat me të tri shkollat e mesme të Komunës së Podujevës dhe debat me komunitetin e biznesit dhe të fermerëve, ku natyrisht se kemi marrë rekomandime, sugjerime dhe propozime nga të gjitha këto debate dhe pastaj është përgatitur raporti përkatës i cili u është dërguar të gjithë juve dhe të cilin do ta shqyrtojmë në këtë mbledhje. Disa nga rekomandimet dhe propozimet që janë bërë në debate publike veç më janë të përfshira dhe tëinkorporuara në dokumentin e propozim SZHEL, mirëpo ne si ekip i kemi shqyrtuar të gjitha ato dhe kemi ardhur në përfundim se një numër i tyre është mirë të miratohen sot në këtë mbledhje në mënyrë që të inkorporohen pastaj në dokumentin final, rekomandime të cilat po i citoj; -propozimi për shpalljen e mjedrës si produkt strategjik, -punësimi i dy ekspertëve të mjedrës, -mbrojtja nga barojat e këqija si një objektivat specifike në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe -partneriteti publiko privat. Gjithashtu në kuadër të sugjerimeve dhe rekomandimeve që

kanë ardhur në formë elektronike përmes e-mail adresës janë edhe këto rekomandime të cilat po ashtu po i citoj; -në faqe 9 të propozimit të SZHEL, te grafikoni i të punësuarve sipas veprimtarisë të shtohet edhe elementi numerik i të punësuarve në sektorin e bujqësisë, pastaj -në faqen 18 të propozimit të SZHEL, te pjesa e kulturës dhe sportit të ofrohen në mënyrë numerike stadiumet e futbollit të madh, fushat e hapura, fushat e mbyllura të futbollit të vogël, fushat e basketbollit, hendbollit, volejbollit, palestra e sporteve me kapacitete për shikues dhe salla e Teatrit me kapacitete për shikues.

z.FidanRekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim propozimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal dhe mendojmë se do të ndikon në zhvillimin ekonomik të Komunës së Podujevës dhe fushave tjera të cilat ndërlidhen me zhvillimin ekonomik të Komunës. Gjithashtu ne i përkrahim edhe propozimet, sugjerimet dhe rekomandimet e bëra nga debatet publike të organizuara nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik duke qenë në dijeni për rëndësinë që ka dokumenti në funksion të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Podujevës.

z.RafetLlapashtica, theksoi, në mbledhjen e KPF-së ka mbet që të sqarohemi me drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik rreth këtij propozimi. Mendoj se dokumenti nuk është miratues por është raport nga takimet dhe debatet publike me qytetarë që janë mbajtur, dhe ne sot nuk miratojmë Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal dhjetëvjeçare sepse ai dokument është në diskutim publik dhe ende nuk është sjellë në Kuvend, mirëpo ne sot po diskutojmë se çka mund të inkorporojmë në atë Strategji që kur të sjellët në Kuvend për miratim, të miratohet si strategji finale. Po ashtu në mbledhjen e KPF-së kolegu z.NaimÇunaku i ka bërëdy vërejtje me vend në raportin e debateve publike, dhe atë, emërtimi me urgjencë i vendbanimeve, ne këtë nuk mund ta përfshijmë në dokument sepse emërtimet e rrugëve janë kryer nga komisioni përkatës por tani është përgjegjësi e Ekzekutivit të Komunës të bëjë shenj[zimin e rrugëve gjë e cila po kërkohet edhe nga qytetarët, si dhe çështja e ngritjes së zonës industriale, e që ekziston Vendimi i Kuvendit sipas të cilit është caktuar ajo zonë mirëpo duhet të bëhet jetësimi apo funksionalizimi i zonës industriale, andaj konsideroj se drejtori i Drejtorisë përkatëse ka pasur mjaftë kohë që të rifreskoj dokumentin e Strategjisë dhe të na sjellë sot në këtë seancë. Sa i përket propozimit që mjedra të shpallet produkt strategjik, ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e përkrahim këtëqëmjedra të jetë një prej produkteve qëpo ka perspektiv në territorin e Komunës së Podujevës, ndërsa sa i përket çështjes së punësimit të dy ekspertëve, ne edhe dje u sqaruam me drejtorin i cili e tha se dy ekspertët punësohen nga vetë shoqata e mjedrës dhe paguhen nga pagesat e anëtarësisë së shoqatës, mirëpo ne edhe në KPF por edhe sot ngrehim shqetësimin tonë rreth kushtëzimit të fermerëve me anëtarësim në shoqatë, pra që mos të kushtëzohen fermerët e rinj që në qoftë se nuk është anëtarë i shoqatës të mos mund tëpërfitoj nga subvencionet. Jemi në dijeni se ka investitorë të ndryshëm të cilët nga mjetet e veta investojnë ku edhe gjenerohen vende të punës gjë e cila është në të mirë tëtë gjithëve, ndërsa konsideroj se nuk bënë të kushtëzohen me anëtarësim në shoqatë në mënyrë që të mund të jetë përfitues i subvencioneve të Komunës, sepse atëherë në bazë të një propozimi apo kërkesë të një kryetari të shoqatës po vejmë një prag për investitorët dhe fermerët, ne jemi kundër barrierave të tilla në një sistem kapitalist ku sa i përket krijimit të vendeve të punës do t'i vështirësohej puna edhe Kryetarit të Komunës i cili e ka sensibilizuar mjedrën si perim-kulturë e cila po ka suksese në Komunën e Podujevës,

andaj ne tani nuk mund të miratojmë apo vejmë barriera të tilla, ndërsa sa i përket punësimit të dy ekspertëve, ne jemi për të ndihmuar zhvillimin ekonomik sidomos sektorin e bujqësisë, por vetëm nëse ekziston mundësia e punësimit të dy ekspertëve qoftë edhe më shumë ekspertëve nëse ka mundësi financiare dhe që punësimet të bëhen me kontratë të rregullte të punës. Pra mendojmë që propozimi për vënie të këtij kushti për anëtarësim në shoqatën përkatëse në mënyrë që të mund të jetë përfitues i ndonjë projekti të Drejtorisë përkatëse nuk bënë të përfshihet në dokumentin e Strategjisë dhe se për këtë çështje është dashur që drejtori i Drejtorisë përkatëse të reflektoj në debatet e zhvilluara me qytetarë para se të sjellët në Kuvend propozimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal, ne kemi pasur kërkesë edhe në shqyrtimin e parë të këtij dokumenti që Kompania fituese cila është paguar për përgatitjen e një dokumenti të mirë në bazë të të dhënave reale që ka Komuna e Podujevës, kompani e cila nuk ka arritur ta bëjë një gjë të tillë dhe mu për shkak ne kemi lëshuar atë seancë, prandaj ne prap po kërkojmë që kurdo që drejtori i Drejtorisë përkatëse e sjellë Strategjinë në fjalë për miratim, të kontaktoj me kompaninë fituese në mënyrë që të harmonizoj dokumentin me të dhëna reale sepse nuk kemi nevojë ne që Komunës së Podujevës t'ia humbim ose t'ia shtojmë më shumë 10 mijë banorë apo t'ia humbim historinë e punës as banorëve të Komunës së Podujevës por as kontributin qoftë të Kryetarit të Komunës qoftë të ndonjërit nga ne që jemi këtu, për arsye se mund të ndodh që stafi i kompanisë hartuese të dokumentit nuk lexojnë të dhëna rreth Komunës së Podujevës por vetëm paguajnë ndonjë historian dhe ato të dhëna i inkorporojnë në dokument, kështu që në mbledhjen e KPF-së drejtori i Drejtorisë përkatëse ka thënë se do ta kontaktoj përfaqësuesin e kompanisë hartuese të këtij dokumenti kurse Kryesuesi i Kuvendit ka kërkuar që ai të jetë prezent në këtë mbledhje, mirëpo këtë e kemi kundërshtuar ne sepse nuk kemi punë me kompaninë por jemi për ta mbikëqyrë atë, dhe nëse ajo kompani e sjellë në seancë atë dokument pa një rifreskim, atëherë mendoj se duhet të reflektoj edhe Kryetari i Komunës për arsye se Kuvendi i Komunës ka dhënë një hipotezë politike dhe posa të del ai dokument në publikim ne i bëjmë keq më së shumti Kryetarit të Komunës, andaj ne Grupi i PDK-së jemi kundër në qoftë se dokumenti nuk rifreskohet edhe pse nuk jemi në dijeni se kur do të sjellët ai dokument për miratim në Kuvend, pra është mirë që të kontaktohet kompania përkatëse dhe të bëjë harmonizimin e dokumentit në mënyrë që ne ta votojmë në Kuvend një dokument ashtu siç duhet të jetë, pra të marrim sot një vendim se çka do të shkon në propozim strategjinë përkatëse që është në interes të qytetarëve, siç ishin, shpallja e mjedres produkt strategjik, pastaj shenjëzimin e rrugëve, mandej jetësimi i zonës industriale dhe çështje tjera të cilat qojnë përpara por nuk mund të kthehemi në retroaktiv, jemi kundër kushtëzimit të fermerëve dhe investitorëve që të jenë anëtarë të shoqatës që të mund të jenë përfitues të subvencioneve, mandej jemi për punësimin e dy apo më shumë ekspertëve në qoftë se Komuna ka mjete financiare për një gjë të tillë sepse do të ndikonte në zhvillimin e mjedres dhe zhvillimin e bujqësisë dhe perim-kulturës në përgjithësi në Komunën e Podujevës, ndërsa për barrierat e propozuara nga shoqata drejtori i Drejtorisë përkatëse është dashur të mos lejoj të bie nën ndikim të asnjë shoqate.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e shoh të arsyeshme të jap disa sqarime, sot kemi të bëjmë me propozim Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2016-2018 e cila ka qenë pikë e rendit të ditës edhe në mbledhjen e muajit janar të këtij viti ku është miratuar Vendimin sipas të cilit ky propozim është vënë në diskutim publik. Debatet

publike me qytetarë dhe grupe tjera të interesit janë zhvilluar, mandej një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa është debatuar për këtë propozim Strategji dhe i kemi dhënë disa rekomandime për këtë mbledhje të Kuvendit për të cilat sot duhet të votohet. Dokumentin bazë të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2016-2018 e posedoni të gjithë këshilltarët e Kuvendit që nga mbledhja e mbajtur më 29 janar 2016, ndërsa për këtë mbledhje ju është dërguar vetëm raporti i Drejtorisë për zbatimin e diskutimit publik ku janë të paraqitura propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet e qytetarëve, andaj sigurisht jeni në dijeni se procedura e miratimit të një dokumenti të tillë është kështu, në materialin bazë inkorporohen propozimet, sugjerimet apo edhe vërejtjet e propozuara nga Ekzekutivi i Komunës, pastaj miratohen dhe rekomandohen nga mbledhja e KPF-së dhe në fund Kuvendi i miraton të njëjtat duke përfshirë edhe ndonjë propozim, sugjerim apo vërejtje që del nga ky debat që po zhvillohet tani në këtë seancë, mandej nëse miratohet me shumicë të votave ai dokument bëhet final. Sa i përket një pjese të diskutimit të këshilltarit parafolës z.Rafet Llapashtica, i'a rikujtoj se Plani Zhvillimor i Komunës është çështje tjetër dhe është e ndarë nga Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal për të cilën jemi duke debatuar ne sot, Plan i cili është miratuar në këtë Kuvend më 02 mars 2016 dhe para tri ditëve kemi marrë konfirmimin e ligjshmërisë nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Pra Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2016-2018 është diçka tjetër në raport me Planin Zhvillimorë Komunal 2016-2025.

z.Naim Çunaku, theksoi, më bëri të marrë fjalën ftesa që në një formë z.Rafet Llapashtica më bëri, është e vërtetë që ne në mbledhjen e KPF-së kemi debatuar për propozim Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2016-2018 dhe për raportin e Drejtorisë përkatëse rreth mbajtjes së debateve publike me qytetarë. Dua të jap disa sqarime edhe pse një pjesë të mirë të fjalëve që unë desha t'i them i potencoj Kryesuesi i Kuvendit, shumica prej këshilltarëve jemi në dijeni se në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur më 29 janar 2016 në rend dita ka qenë propozimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2016-2018 ku është debatuar dhe në fund është marrë vendim për vënien e atij dokumenti në diskutim publik, ndërsa në mbledhjen e djeshme të Komitetit për Politikë dhe Financa por edhe sot në këtë mbledhje para vetës kemi raportin nga debatet publike që janë mbajtur rreth propozim Strategjisë në fjalë. Nga fjala hyrëse e drejtorit z.Avni Fetahu del se nga debatet publike kemi pasur iniciativë, sugjerime dhe propozime ku disa prej tyre konsideroj se nuk janë në kompetencë të Kuvendit të Komunës por janë kompetenca të nivelit qendrorë ku një prej tyre kishte të bënte me kurrikulën e arsimit e të tjera, mirëpo poenta ishte që kishte edhe çështje tjera të propozuara që tani më ky Kuvend i ka të kryera, shembull, vërejtja ishte që një prej sugjerimeve që është bërë për emërtimin e rrugëve, e që ne atë punë e kemi të kryer, pastaj ka qenë sugjerim inicimi i zonës industriale e që edhe për këtë ne si Kuvend e kemi një vendim, por mund të jetë vetëm funksionalizimi i zonës industriale, pra këto ishin ato vërejtjet e bëra në mbledhjen e KPF-së me qëllim që të gjejmë mënyrën më të mirë që ato propozime ose sugjerime t'i inkorporojmë në dokumentin final të Strategjisë në mënyrë që Strategjia në fjalë të jetë sa më përmbajtësore dhe të ngërthen në vete ide për zhvillimin e Komunës për periudhën kohore 2016-2018. Gjithashtu edhe sot e kemi të hapur këtë dokument ku të gjithë ne mund të japim ide, sugjerime dhe propozime për të cilat ne mendojmë se do ta debatojmë dhe pasurojmë këtë Strategji, dhe si e tillë, nëse sot ky dokument miratohet, kjo do të jetë Strategji e Zhvillimit Ekonomik Lokal se si do të duket Komuna e Podujevës në vitin 2018. Një element që më ka shtyrë të jem përkrahës i kësaj Strategjie e që vlen të theksohet

është harta interaktive ku për herë të parë Komuna e Podujevës e ka një pasqyrë reale mbi gjendjen, të dhënat dhe specifikat që ka Komuna.

z.Haki Rudari, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje e kemi diskutuar propozimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2016-2018 dhe realisht ne në vazhdimësi angazhohemi për zhvillim të qëndrueshëm dhe për projekte të ndryshme të realizuara qoftë në infrastrukturë, bujqësi, përkrahje të bizneseve të reja e jo favorizim të bizneseve, pastaj për arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale, kulturë, rini dhe sport, në parim është kjo por megjithatë kjo propozim Strategji nuk i përmbush kërkesat e qytetarëve. Edhe në mbledhjen e KPF-së e kam cekur dhe po e përsëris se vërejtja e parë që ne kemi është tek, informata qytetarëve, gjë për të cilën ne mendojmë se jo të gjithë qytetarët kanë facebook për të përcjellë zhvillimet e ndryshme politike, dhe lidhur me këtë ne më parë jemi marrë vesh që kur kemi të bëjmë me diskutime publike me qytetarë, fillimisht 15 ditë më herët të kemi informata nëpër vende të frekuentuara të Komunës tonë, e jo vetëm brenda objektit të Komunës, për arsye se ndodh që edhe neve këshilltarëve na kalon ndonjë debat pa qenë në dijeni, e mos të flasim për qytetarë e biznese të ndryshme, andaj mendoj se kur po kemi takime me qytetarë ata po janë të padijshëm dhe nuk po kanë informata lidhur me këto diskutime por edhe me zhvillime të ndryshme qoftë subvencione dhe të tjera. Çështje tjetër, u përmenden subvencionet, unë edhe në mbledhjen e KPF-së e përmenda dhe e dhashë një vërejtje se është viti i tretë që jemi brenda këtij Kuvendi dhe të gjitha subvencionimet janë bërë nga komisioni komunal pa ndonjë rregullore të veçantë, ndërsa sa kam vërejtur dhe shfletuar në Komunat tjera në rregulloret për ndarjen e subvencioneve përfshihen 2 anëtarë këshilltarë të Kuvendit të Komunës kurse 3 anëtarë tjerë caktohen nga Drejtori të ndryshme të Komunës përkatëse, e kjo në Komunën e Podujevës nuk ka ndodh asnjëherë që për ndarjen e subvencioneve të Komunës të zgjedhët një komision ku do të përfshiheshin së paku dy anëtarë nga Kuvendi i Komunës ku një natyrisht se do të ishte nga partia në pushtet dhe një nga opozita, dhe në këtë drejtim mendoj se është momenti i fundit që në përgjithësi Komunat të ndërmarrin hapa për arsye se vetëm në këtë mënyrë do ta ngritnin transparencën para qytetarëve, dhe jo që ndarja e subvencioneve të bëhet vetëm nga një komision i caktuar nga organet komunale.

Në rast se hyjmë në detaje të propozim Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2016-2018, më duhet ta them se më shumë është vetëm përshkruese dhe më shumë është në aspekt gjeografik ku tregohet sa është gjatësia dhe gjerësia e Liqenit të Batllavës, pastaj flitet rreth Lumit Llap e të tjera, pra përshkrim gjeografik, shtroj pyetje, cilat janë projektet nga ujërat, nga hidrologjia, pastaj jemi dëshmitarë të hedhjes së kanalizimeve në Liqenin e Batllavës e që sipas kësaj Strategjie furnizohen me ujë më shumë se tri Komuna, ndërsa unë nuk kam vërejtur ndonjë projekt për mbrojtjen e Liqenit të Batllavës, andaj nuk mund ta përkrahim këtë propozim Strategji kështu si është, pastaj Çuka e Batllavës, shumë mirë që përshkruhen pasuritë dhe detaje të ndryshme për këtë, mirëpo nuk ka ndonjë projekt konkret, dhe për këtë unë që dy vite kam bërë pyetje, kurse ai vend vazhdimisht është duke u degraduar. Çështja tjetër është tek turizmi, realisht në këtë propozim Strategji përmendet turizmi, mirëpo nuk ka projekte se si zhvillohet turizmi, dhe këtë çështje unë edhe më parë e kam përmendur, dhe ne sigurisht jemi në dijeni se Komuna e Podujevës ka një pozitë të mirë për zhvillimin e turizmit, por në këtë Strategji nuk përmenden se cilat janë projektet për zhvillim të turizmit e që ne natyrisht se do t'i përkrahim. Çështje tjetër është edhe mbrojtja e monumenteve të ndryshme, shtëpia

muze e Heroit HasanRamadaniështë në mbrojtje, mirëpo në këtë Strategji askund nuk e kam vërejtur që ajo shtëpi është dhe duhet të merret në mbrojtje, pra është shpallur monument në mbrojtje kurse në këtë Strategji mungon mbrojtja e shtëpisë, andaj mendoj se është mirë të inkorporohet në Strategji. Çështje tjetër që realisht është vërejtje dhe që nuk mund t'i ikim është plani strategjik ku thuhet se deri në fund të vitit 2016 duhet të bëhet inventarizimi i pronës komunale që mund të jepet për nevoja ekonomike, përse nuk është bërë një gjë e tillë në vitet e mëparshme por të presim deri në vitin 2016, andaj nuk mund të ketë arsyetim, dhe realisht unë disa herë e kam thënë se në Komunitat ku ka ndërrime të pushtetit mund të arsyetohet maksimum një vit, mirëpo ky problem në Komunën tonë nuk ka ndodh dhe vazhdimisht është e njëjta parti e që nuk ka arsyetim në këtë drejtim. Çështje tjetër është, funksionalizimi i zyrës së diasporës, mendoj se diasporën e kemi me vite të tëra dhe kjo gjëështë dashur të bëhet më herët sepse diasporën nuk e kemi vetëm në vitin 2016. Gjithashtu çështje tjetër e cila është mirë të diskutohet është edhe për objektin e pushimores së fëmijëve e cila gjendet në fshatin Orllan për të cilën thuhet se deri në fund të vitit 2018 bëhet funksionalizimi dhe ridestinimi i atij objekti, shtroj pyetje a mund ta dijmë ne se cili është ai ridestinim i atij objekti, për arsye se më parëështë thënë pushimore e fëmijëve ndërsa tani thuhet ridestinim i atij objekti dhe ne nuk jemi në dijeni për çfarëridestinimi bëhet fjalë. Pastaj në propozim Strategji thuhet deri në vitin 2018 bëhet eliminimi i tërësishëm i deponive ilegale, e që unë mendoj se kjo çështje duhet të ndodh në vitin 2016, e që vlen të ceket se në një takim që kemi pasur me përfaqësuesit e grupeve të këshilltarëve të Kuvendit me një delegacion nga Gjermania përveç përshtypjeve të mira që kanë pasur vërejtja kryesore e tyre ka qenë për deponitë ilegale, andaj mendoj se është mirë që eliminimi i atyre deponivedhe marrja e masave përkatëse të bëhet brenda vitit 2016 dhe mos të mbetet deri në vitin 2018. Njëçështje e cila më ka bërë përshtypje është amza e cila është në fund të dokumentit, çështje për të cilën është mirë ta diskutojmë sepse prap përsëritet riparimi i rrugëve ku nuk ka specifikim të rrugëve por vetëm thuhet riparim i disa rrugëve nëpër fshatra përkatës, pra është mirë ta dijmë se për cilat rrugë bëhet fjalë sepse emërtimi i rrugëve është bërë ose së paku të cekën lagjet. Vazhdimisht në takimet me qytetarë që kemi, ankesat e tyre janë që ardhjet e projekteve po bëhen në Drejtorinë komunale të infrastrukturës, konkretisht jam në dijeni se nga fshati prej nga unë vijë para një kohe ka ardhur një projekt nga lagjja Mulolli dhe Mehmeti, andaj është mirë që nëse fshatrat nuk kanë projekte të zëvendësohen me projekte të cilat janë përgatitur nga vetë banorët e fshatrave, prandaj mendoj se kjo mund të jetë esenca që nuk specifikohen për cilat rrugë bëhet fjalë sepse nuk kanë projekte, ndërsa në vendet ku qytetarët kanë hartuar projekte ato nuk kyçen, pra në këtë drejtim është mirë të keni para sysh më shumë.

znj.FatlumeJaha, theksoi, arsyeja që unë sot pikërisht mora fjalën dhe dola në këtë foltore të Kuvendit të Komunës është fakti që neve në vazhdimësi po na përcjellë një avaz që kinse po jepen propozime të caktuara dhe ato nuk po merren parasysh, dua ta ritheksoj dhe ta bëjë të qartë se një Strategji e mirë e zhvillimit të Komunës tonë nuk i konvenon vetëm një Grupi të caktuar politik, por na konvenon të gjithëve, prandaj është mirë që të jepen propozime konkrete dhe këtë propozim Strategji ta kristalizojmë si të tillë në mënyrë që të jetë sa më e pranueshme, ngase absolute nuk ka asgjë në këtë botë. Pra nuk është e drejtë të thuhet se nuk merren parasysh vërejtjet sepse fundja ne këshilltarët e Kuvendit e kemi mandatuar Drejtorinë përkatëse që të organizoj dhe të zhvilloj debate publike me qytetarë rreth këtij propozim dokumenti, Drejtoria një gjë të tillë

e ka bërë ku detyrë e saj ka qenë që në Kuvend të sjellë propozimet dhe rekomandimet konkrete të dala nga debatet publike e që ne i kemi paravetës ato rekomandime ashtu në detaje dhe origjinale siç janë, prandaj ka vend që ne t'i kristalizojmë dhe t'i zgjedhim opsionet më të mira të mundshme, andaj preferoj të mos zgjerohemi shumë por të përqendrohemi rreth propozimeve që kemi paravetës. Po ashtu u tha se nuk janë marrë parasysh propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet e bëra, mirëpo edhe pse shumica prej nesh këtu nuk jemi anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, në hyrje të kësaj mbledhjeje neve na u dorëzuan rekomandimet apo raporti nga mbledhja e KPF-së ku të gjitha rekomandimet e dhëna janë të përfshira në atë raport, prandaj mendoj se do të ishte mirë që t'i shohim gjërat në një hark sa më të ngushtë dhe ta bëjmë një strategji sa më të mirë të mundshme. Unë konsideroj se në këshilltarët e Kuvendit i kemi të gjitha propozimet konkrete të cilat nëse votohen ato do të përfshihen në dokumentin final të Strategjisë. Gjithashtu u përmend edhe çështja e emërimit të rrugëve, ne nuk mund t'ua definojmë njerëzve, sepse jemi në dijeni se në debate publike me qytetarë marrin pjesë persona të të gjitha niveleve, prandaj ne nuk mund t'ua tregojmë atyre mënyrën se si t'i bëjnë propozimet e tyre, por e jona është që ato propozime t'i shqyrtojmë dhe t'ua japim emërtimin e duhur, lidhur me emërtimin e rrugëve unë kam qenë anëtarë e komisionit përkatës dhe e ndjej për obligim ta them se puna tani më është kryer, por njerëzit në debate publike kanë propozuar në atë mënyrë, mirëpo sigurisht se atyre ju është bërë e qartë se puna rreth emërtimeve të rrugëve është kryer dhe pritet vetëm shenjëzimi i tyre, dhe unë vetëm këtë e pash si rekomandim nga mbledhja e KPF-së.

znj.AdelinëStublla, theksoi, në Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje mendojmë se do të kishte qenë në të mirë të qytetarëve që në këtë Strategji të futet planifikimi i qendrës emergjente në lokacionin e objektit të ish autoshkollës Instruktori, po ashtu si çështje tjetër e cila do të ishte në të mirë të qytetarëve është edhe ndërtimi i njëqerdheje publike në njërin prej fshatrave e që mendoj se do të kishte qenë në të mirë të asaj ane, çështje tjetër që është në të mirë të qytetarëve është edhe planifikimi i sipërfaqes prej 48.78 hektarë, që ka qenë edhe premtim i Kryetarit të Komunës, në rrugën "Skenderbeu", hapësirë kjo e planifikuar për një qendër sportive me fusha të hapura të tenisit, voleybollit, futbollit dhe basketbollit, qendër e cila do të kishte qenë në të mirë të qytetarëve pasi që mungojnë vendet se ku mund ta kalojnë të rinjtë Llapjan kohen e lirë.

z.RafetLlapashtica, theksoi, jemi në dijeni se në KPF nuk mund të merren vendime por vetëm jepen rekomandime dhe ne të gjithë anëtarët e KPF-së jemi pajtuar që t'i rekomandojmë Kuvendit për rendin e propozuar të ditës në mënyrë që sot të debatojmë dhe të marrim vendim për çështje të ndryshme duke përfshirë edhe për propozimin e Strategjisë në fjalë, dhe ne sot duhet të marrim një vendim se si do të duket Strategjia, gjë e cila varet nga këshilltarët e Kuvendit se si do të votojnë, nëse nuk votohet, ky dokument ndalet sot këtu, por nëse mendojmë se ndonjë këshilltarë i Kuvendit të Komunës së Podujevës nga të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në këtë Kuvend e din se si do të bëhet zhvillimi i turizmit ose që ka ndonjë projekt për këtë çështje, atëherë do të ishte në rregull, mirëpo unë nuk pash dokument që drejtori i Drejtorisë përkatëse e ka sjellë në Kuvend, është e vërtetë se kemi autorizuar Drejtorinë përkatëse që të mbaj debate publike, dhe mund të jetë e vërtetë që banorët e fshatrave ta ngatërrojnë emërtimin e rrugëve me shprehjen shenjëzimin e rrugëve, mirëpo neve kur të na sjellët një dokument duhet pasur parasysh se ne jemi zyrtarë, andaj nëse sjellët nga drejtori i

Drejtorisë një propozim me nënshkrim të tij ku thuhet emërtimi i rrugëve unë sigurisht se jam kundër sepse nuk di se çfarë është biseduar në debate publike, por drejtori është dashur që të rifreskoj dokumentin. Çështja tjetër është se në propozim Strategji nuk është asnjë projekt për mbrojtjen e ujërave dhe zhvillimin e turizmit e që as Kryetari të Komunës nuk i është paraqitur njëj tillë, dhe që ne këshilltarët e Kuvendit nuk jemi për këtë çështje por janë drejtorët e Drejtorive, por në qoftë se ne e miratojmë kështu siç është sigurisht se Kryetari i Komunës nuk do të mund ta dijë se si do të duket Komuna e Podujevës në fund të viti 2018. Po ashtu drejtori i Drejtorisë përkatëse nuk ka projekt se si të ndaloj ujërat e zeza që derdhen në Liqenin e Batllavës, pastaj nuk ka projekt për zhvillim të turizmit, nuk ka projekt për eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave, prandaj edhe ne si opozitë e këtij Kuvendi po dalim në pozicion jo të mirë që të votojmë kundër këtij dokumenti, edhe pse dëshira jonë do të ishte që dokumenti të jetë gjithçka në rregull.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, të nderuar kolegë ka njerëz të cilët dinë të ndërmarrin veprime të arsyeshme ndërsa janë të tjerët që dinë t'i arsyetojnë veprimet. Zhvillimi i Komunës së Podujevës nuk ka ngecur për shkak të mungesës së strategjive sepse strategji të tilla ka pas përherë, mirëpo implementimi i tyre na ka sjellë në një pikë ku shumica e Llapjanëve, për fat të keq, që kanë mund ta bëjnë një kapital solid financiarë, kanë ikur prej Llapit dhe bizneset e tyre i kanë zhvilluar jashtë Komunës së Podujevës, dhe sot kemi ardhur në një pikë ku veçanërisht gjenerata e re me shumë interesim e pret liberalizimin e vizave për tëmund që zhvillimin dhe afirmimin e vet, për fat të keq, ta realizojnë jashtë vendit.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe i autorizuar për ushtrimin e të gjitha kompetencave të drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, theksoi, dëshiroj të jap disa sqarime rreth disa diskutimeve të disa këshilltarëve parafoles, dhe po filloj me këshilltarin z.Rafet Llapashticën të cilin sa unë e kuptova në diskutimin e tij të parë e ka ngatërruar këtë propozim Strategji sepse nuk është Strategji dhjetëvjeçare por është 3 vjeçare, si dhe nuk është Strategji e Planit Zhvillimor Komunal por është Strategji e Zhvillimit Ekonomik Lokal, gjithashtu unë në fjalën hyrëse e potencova se disa nga pikat ose rekomandimet e dala nga debatet publike janë të përfshira apo të inkorporuara në kuadër të dokumentit të propozim Strategjisë në fjalë, ndërsa propozimet, sugjerimet dhe rekomandimet nga debatet publike të cilat janë në raportin përkatës janë paraqitur për shkak të transparencës përkatësisht ashtu siç janë paraqitur në debate ashtu edhe i kemi paraqitur ne në raportin përkatës. Sa i përket rekomandimit për kusht për anëtarësim në shoqatë, unë askund nuk e thash se ju duhet ta votoni atë rekomandim dhe nuk është rekomandim i propozuar nga grupi punues i propozim Strategjisë, mirëpo është rekomandim i komunitetit të biznesit. Unë konsideroj se harmonizimi dhe bashkëpunimi me shoqata është jetik për tëqenë përfitues i donacioneve të Komisionit Evropian dhe nga donatorë të tjerë, dhe në këtë aspekt vlen të përmendet se projekti përkatësisht pika për grumbullimin dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në shumë afër gjysmëmilion euro i cili është duke u bërë në fshatin Sfeçëlështë bërë pikërisht në bashkëpunim me Shoqatën "Shpresa e Llapit" sepse kjo ka qenë kusht për aplikim sepse Komuna e vetme nuk ka mundur të aplikoj, kështu që nuk është mirë t'i relativizojmë shoqatat të cilat janë duke operuar në Komunën e Podujevës por të koncentrohemi në bashkëpunim me ato shoqata ngase në qoftë se Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të specifikave të veta që ka e publikon një thirrje për aplikim për mjedra dhe koordinohet me një shoqatë që aplikuesit të anëtarësohen në atë shoqatë konsideroj se asgjë të keqe nuk ka sepse në një formë punësohen ekspertët

përkatës dhe një formë ato mjete në një formëprap kthehen në mënyrë indirekte tek aplikuesit, por si do që të jetë nuk është rekomandim që ne e kemi kërkuar.

Me qëllim që të mos ketë hamendje sa i përket rekomandimeve, unë po i citoj edhe njëherë rekomandimet që grupi punues i ka propozuar, dhe atë; -propozimi për shpalljen e mjedërës si produkt strategjik, -punësimi i dy ekspertëve për mjedër, -mbrojtja nga barojat e këqija si objektiv specifike e Drejtorisë dhe –partneriteti publiko privat, ndërsa rekomandimet e propozuara nga debatet publike shumica prej tyre veç janë të përfshira dhe tëinkorporuara në dokumentin e propozim Strategjisë përkatëse.

Sa i përket propozimeve dhe vërejtjeve të bëra nga z.HakiRudari, lidhur me futjen në mbrojtje të disa monumenteve, unë konsideroj se Strategjia nuk ka kapacitet të përfshijëmonumente të ndryshme në mbrojtje por ato monumente duhet të sjellën në Kuvend si pika të veçanta dhe të votohen si të tilla, kështu që nuk janë pjesë e Strategjisë ato çështje, po ashtu lidhur me vërejtjen e bërë për amzën e projekteve, ju sqaroj se ato projekte janë miratuar me rastin e shqyrtimit dhe miratimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2016-2018, dhe nga ajo Kornizë qëështë votuar nga ky Kuvend i kemi marrë ato projekte dhe i kemi përfshirë në Strategji me qëllim që projektet e parapara të kenë mbulesë buxhetore. Po ashtu u potencua edhe fusha e turizmit, unë ju sqaroj dhe ua rikujtoj se edhe në mbledhjen e Kuvendit kur është diskutuar për këtë propozim Strategji përkatësisht kur është miratuar vendimi për vënie në diskutim publik, e kam përmendur që dokumenti i propozim Strategjisë ka pasur 169 faqe dhe nuk e kemi parë të arsyeshme ta bëjmë voluminoze sepse asnjë investitor nuk koncentrohet të lexoj 169 faqe, por ne e kemi kategorizuar, shembull, rreth profilit të Komunës e kemi fletushkat në gjuhë shqipe dhe atë angleze, Investo në Komunën e Podujevës, ku kategorizohen pika të cilat u përmendën, gjithashtu edhe në fushën e turizmit janë të paraqitura objekte në fletushka të ndara rreth investitorëve të caktuar, si dhe çështje dhe fletushka tjera të rëndësishme.

z.RafetLlapashtica, theksoi, në mbledhjen e KPF-së, me propozim të Kryesuesit të Kuvendit u pajtuam që drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik të definoj qartëçështjet e ngritura si shqetësime të anëtarëve të KPF-së. Pyetje konkrete për drejtorin z.AvniFetahu, a e përkrasni ju dhe a është propozim i juaji që fermerët të kushtëzohen me anëtarësim në shoqatë që të jenë përfitues të mundshëm të subvencioneve, apo jo.

Çështja tjetër, ne jemi duke debatuar për një dokument ashtu siçështë sjellë para dy apo tri seancave, ndërsa ky qëështë sjellë për këtë mbledhje është raport nga takimet ose debatet e mbajtura me qytetar, nuk kamë qëllim vetëm të kritikoj, mirëpo po të ishit drejtor i përgjegjshëm është dashur që sot tësjellëni një dokument, propozim apo raport konkret me pika konkrete në mënyrë që ne sot të miratojmë pika apo propozime konkrete, e jo të sjellët raport se çka është biseduar me banorë të fshatrave e gjëra tjera. Pra ne sot jemi duke kërkuar nga drejtori i lartcekur se a është propozim i tij dhe a jeni që të hedhet në votim ky raport për zbatimin e diskutimeve publike, apo nuk jeni.

z.AgimVeliu, Kryetar i Komunës, theksoi, gjatë diskutimeve u bënë disa vërejtje, nuk jam dakord që subvencionet dhe donacionet e ndryshme të Komunës të jenë të kushtëzuara me anëtarësim nëasnjë shoqatë, çfarëdo qofshin ato, anëtarësimi në shoqata është vullnetar, anëtarësimi dhe pagesat për anëtarësi bëhen sipas dëshirës së individëve, pa kushtëzime. Në asnjë shpallje tëKomunës së Podujevës nuk guxon të ketë kushtëzime që të jetë anëtarë i ndonjë shoqate përkatëse, për përfitim të ndonjë

subvencion apo përkrahje tjetër, pra jam kundër diskriminimit të atyre që janë anëtarë të shoqatave dhe atyre që nuk janë. Kështu qëky propozim nga debatet publike nuk ka vend nëdokumentin e propozim Strategjisë në fjalë. Gjithashtu jam dakord edhe me vërejtjet tjera që u dhanëedhe sa i përket asfaltimit të disa rrugëve dhe projekteve tjera ku nuk precizohen emërtimet e rrugëve apo lagjeve. Pasi qëprocesi i emërtimeve të rrugëve ka përfunduar është mirë që projektet të emërtohen me emra të rrugëve, pra asgjë të keqe nuk ka, nëse ka projekt realizohet, nëse joështë rishikimi i buxhetit dhe diskutojmëprapçështjen ku mund të marrim vendim së bashku. Sa i përket asaj që deri më tani u diskutua rreth propozimit nga debatet publike lidhur me emërtimet,shtrohet dilema se a kemi të bëjmë me emërtim të rrugëve apo me emërtim të vendbanimeve, e që për mendimin tim nuk është e njëjta gjë, por janëdy çështje të ndryshme. Jemi në dijeni se procesi i emërtimeve të rrugëve ështëkryer, mirëpo nëse ka propozime dhe kërkesa për emërtim të vendbanimeve, lagjeve, e tjera, atëherë pse jo, mund të shikojmë mundësit për të filluar edhe me këtë proces.

Konsideroj se është mirë që dokumenti i propozim Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal për periudhën 2016-2018 të miratohet me këto vërejtje, nëse eventualisht kushtëzimet për anëtarësim në shoqata janë të përfshira në dokument, ato të hiqen, si dhe të shikohen edhe vërejtjet tjera në mënyrë që të bëhen plotësimet dhe korrigjimet përkatëse.

z.MehmetGashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në bazë të reagimeve që vërejta konsideroj se shumica prej këshilltarëve u pajtuan me propozimet e Kryetarit të Komunës. Andaj materialin bazë, propozimet, rekomandimet dhe vërejtjet nga diskutimet publike të cilat janë marrë për bazë edhe nga Drejtoria përkatëse, rekomandimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, vërejtjet të cilat ishin me vend gjatë diskutimeve në këtë mbledhje si dhe propozimin e Kryetarit të Komunës, i hedh në votim me rekomandim që nëse miratohet Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik obligohet qëmaterialin bazë ta spastroj dhe njëkohësisht të bënëinkorporimet e nevojshme.

Pas votimit u konstatua që me 31 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, u miratua propozim Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Podujevës për periudhën 2016-2018, me rekomandim që të bëhet rifreskimi i dokumentit dhe inkorporimii rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa, rekomandimeve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik përkatësisht Grupit punues dhe sugjerimeve dhe vërejtjeve të dhëna në këtë mbledhje.

4. Propozimi i Rregullores për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre

➤ Raporti për zbatimin e diskutimit publik

z.MehmetGashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe për këtë propozim janë mbajtur debatet publike dhe po ashtu është përgatitur raporti përkatës, andaj fjalën hyrëse ja jap drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

z.AgronHyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e paraqiti fjalën hyrëse ku ndër të tjera theksoi, ne si Drejtori në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës, kemi organizuar dhe mbajtur debatin publik rreth kësaj propozim rregulloreje e cila paraprakisht është publikuar nëveb-faqe zyrtare të Komunës, pastaj Zyra për marrëdhënie me publikun dhe informim ka bërë informimet elektronike dhe të shkruara në mënyrë që të gjithë të interesuarit të kenë mundësinë që materialet përkatëse t'i marrin me kohë dhe propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet e tyre të kenë mundësi t'i adresojnë brenda afateve kohore. Diskutimi publik ka zgjatur 30 ditë përkatësisht nga data 02 mars 2016 deri më 01 prill 2016, kurse debati me qytetarështë mbajtur 23 mars 2016 në këtë sallë, ku gjatë kësaj periudhe por as në debatin publik me qytetarë nuk është paraqitur asnjë propozim, sugjerim, plotësim apo vërejtje rreth këtij propozimi.

z.FidanRekaliu, theksoi, ne këshilltarët e Kuvendit nga radhët e LDK-së e përkrahim këtë propozim Rregullore për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre, për të cilën mendojmë se është shumë e rëndësishme. Sa i përket diskutimit publik, besoj se kjo rregullore është e hartuar profesionalisht ngase ky propozim është përgatitur dhe hartuar nga ekspertë të kësaj lëmie, mirëpo vetëm uroj që kjo rregullore të zbatohet në praktikë. Unë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kërkoja nga drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që të zhvillohen sa më shumë fushata vetëdijësuese nëpër shkollat e Komunës së Podujevës me qëllim tëvetëdijimit të nxënësve për të drejtat e tyre dhe për dukurit devijante të cilat ndikojnë në të ardhmen e tyre.

z.RafetLlapashtica, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës e mbështesim në parim këtë propozim Rregullore për të cilën konsiderojmë se është e mirë dhe i bënë mirë fëmijëve, nxënësve dhe të gjithë neve, mirëpo konsiderojmë se do të jetë e vështirë të zbatohet nga ana e Drejtorisë sëInspeksionit dhe organeve tjera ngase në të përfshihen fenomene ku po thuajse në të gjithë botën ka probleme të tilla, shembull, konsumimi i duhanit, alkoolit etj. nga të miturit. Po ashtu e mbështesë edhe kërkesën e parafolësit z.FidanRekaliuqë të organizohen fushata të ndryshme nëpër shkolla qoftë nevoja edhe ne si Kuvend t'i ndihmojmë drejtorët e shkollave me qëllim të sensibilizimit dhe vetëdijimit të nxënësve për dukuri të ndryshme. Pra është një propozim Rregullore e cila në terren kërkon më shumë punë dhe angazhim, mirëpo është edhe problem censurimi i këtij fenomeni sepse ka edhe qytetarë të rritur të cilët nuk ju përmbahen këtyre rregullave, shembull, konsumojnë duhan por i dërgojnë fëmijët e tyre të mitur për të blerë, andaj moralisht organet mbikëqyrëse vihet në një situatë ku nuk din se si të veprojnë kur kemi parasysh situatën e vështirë ekonomike të qytetarëve të Kosovës dhe menjëherë nuk mund të shqiptohen gjopa të thella, por si do që të jetë mendoj se të gjithë do të mundohemi të kontribuojmë nëkontuinitet të kësaj rregulloreje në mënyrë që sa më shumë të mundohemi që të rinjtë dhe fëmijët, deri ta arrijnë moshën madhore, të mos hynë në rrugë të gabuara. Gjithashtu kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit që në bashkëpunim me drejtorët e shkollave të kenë kujdes më të shtuar së paku brenda oborreve të shkollave që dukuritë e ndryshme të cilat dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e të miturve të mos përdoren, dhe në raste të pengesave ose nevojës për ndihmë të kontaktoj edhe me Drejtorinë e Inspeksionit, Policinë dhe me neve si Grupe të këshilltarëve të Kuvendit në mënyrë që sa më shumë të jetë mundur të ndalohen këto gjëra aq më mirë qo të jetë për të ardhmen tonë. Pra në parim e

mbështesim këtë propozim Rregullorë dhe njëkohësisht kërkojmë zbatimin e saj sa më shumë të jetë e mundur.

z.HakiRudari, theksoi, edhe në mbledhjen e KPF-së kemi debatuar për këtë propozim Rregullorë, për të cilën mendojmë se si rregullorë është e mirë por gjëja më e mirë do të ishte implementimi saj, gjë për të cilën mendoj se duhet të përcillet implemnetimi dhe zbatimi i saj. Për Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2016-2018 janë mbajtur disa takime publike nëpër shkolla andaj mendoj se para se të sjellët në Kuvend për shqyrtim pikërisht edhe për këtë propozim Rregullorë është dashur të mbahen takime publike nëpër shkolla të mesme dhe ato fillore për arsye se kjo rregullorë kryesisht ka të bëjë me nxënës apo fëmijë të moshave 14 deri në 18 vjeçar. Çështje vërtetë e ndjeshme është shitja, shërbimi apo përdorimi i pijeve alkoolike dhe duhanit në shkolla të ndryshme, ku në rast se vizitojmë shkolla të ndryshme mund të vërejmë se nxënësit janë duke përdorur duhani çdo herë e më shumë andaj mendoj se në këtë drejtim është mirë të bëhet më shumë, mirëpo tek neni 3.1 të kësaj propozim Rregullorëje, unë edhe në mbledhjen e KPF-së shtrova pyetje por nuk mora përgjigje të prerë, ku thuhet, *ndalohet rreptësisht shitja dhe përdorimi i të gjitha pijeve alkoolike dhe të duhanit brenda objekteve edukativo-arsimore*, pra meqëprezent këtu janë drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, unë shtroj pyetje, neni 3 a ka të bëjë vetëm brenda objektit shkollorë apo edhe brenda oborrit të shkollës, për arsye se është një dallim shumë i madh dhe nëse nuk është i përfshirë oborri i shkollës unë mendoj se duhet të përfshihet, pra paragrafi 1 i nenit 3 të definohet më qartë. Gjithashtu tek implementimi i kësaj propozim Rregullorëje përkatësisht neni 6 ku thuhet, *inspektorët komunal dhe Policia do të kujdesen dhe do të mbikëqyrin zbatimin e kësaj rregullorë nga subjektet përkatëse dhe do të ndërmarrin masat dhe veprimet përkatëse sanksionuese*, unë shtroj pyetje, cilat janë masat dhe cilat masa sanksionuese janë ndërmarrë deri tani, për arsye se nëse dalim dhe vizitojmë trotuare, hapësira, sheshe dhe pjesë të ndryshme të qytetit, do të vërejmë trotuare të bllokuara nga veturat, do të vërejmë prona të uzurpuara nga parkingje të ndryshme, pastaj nga lokalet e ndryshme madje si duket do të mbulohet edhe hekurudha me lokale, gjëra të cilat mendoj se janë përgjegjësi e Ekzekutivit të Komunës apo Drejtorisë përkatëse.

z.FlakronGashi, theksoi, dua të shtojë diçka sa i përket propozim Rregullores në fjalë, konsideroj se secili prej nesh kupton ngapak nga fusha juridike, rregulloret për nga fuqia juridike janë më të vogla se sa ligjet dhe përderisa ekzistojnë ligje të cilët shprehimisht i përcaktojnë çështjet e tilla, shembull për konsumimin e duhanit, alkoolit e gjëra të tjera, dhe nuk janë zbatuar dhe nuk janë marrë vendime, atëherë si do të zbatohet një rregullorë e tillë, unë dyshoj në këtë, jo pse kam qejf mirëpo në praktikë është e tillë, dhe secili nga ne mund të shikojmë lokale afariste të cilat operojnë afër shkollave të mesme ku në ato vende shërbehen edhe pije alkoolike, konsumohet edhe duhani e që rreth 80% e atyre nxënësve janë nën moshën e rritur. Unë do të doja që Inspektorati i Komunës të bëjë më shumë e jo vetëm të thirren në emër të inspektorëve dhe të marrin paga, por të dalin në terren dhe ta kryejnë punën e tyre, mirëpo kur sheh se edhe në bufen e objektit të Komunës konsumohet duhani, atëherë nuk e di se cili është shembulli më i mirë se si do të jetë e ardhmja.

z.MehmetGashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, mendoj se propozimi i kësaj Rregullorëje është i përgatitur mirë nga profesionist të fushës. Shqetësimet apo kërkesat e këshilltarëve parafolës por edhe nga mbledhja e KPF-së janë se si të implementohet

dhe zbatohet kjo rregullore. Po ashtu shumë mirë u cek se ligjet janë më të fuqishme se rregulloret, andaj kjo propozim Rregullore është bazuar në ligjet përkatëse, mirëpo problem është implementimi i saj ku mendoj se nuk mund ta bënë vetëm një institucion i vetëm por duhet të jetë obligim i të gjithëve duke përfshirë shkollat, mësimdhënësit, Inspeksionin edhe qytetarët, andaj shpresoj se do të bëhen përpjekje që edhe këtë rregullore ta implementojmë ashtu siç kërkohet.

z.FlakronGashi, theksoi, i nderuari Kryesues i Kuvendit, shpesh herë duke dashur t'i përmbledh ato çka ne themi gjatë diskutimeve tona, po na qitni krejt në situata tjera. Këshilltarët e Kuvendit dhe qytetarët nuk janë të thirrur të mbrojnë ligjin. Më thoni cilat raste janëku inspektorët e Komunës kanë inspektuar lokalet afariste që veprojnë afër shkollave të mesme dhe fillore, nëse mund të më tregoni këtë atëherë është në rregull.

z.MehmetGashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, unë e ceka se kjo propozim Rregullore është përgatitur dhe hartuar nga një organ profesionist i nivelit qendrorë por Komunave iu është dhënë mundësia që ta shqyrtojnë dhe ta modifikojnë sipas specifikave përkatëse komunale, mirëpo pothuajse në të gjitha Komunat e Kosovës është miratuar si e tillë.

z.NexhmiRudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, sa i përket sqarimit të cilin e kërkoj këshilltari z.HakiRudari, gjithçka qëështë në pronësi të shkollës është objekt shkollorë, pra nuk është vetëm ndërtesa por janë edhe rrethojat, edhe oborri, edhe gjelbërimi e tëtjera. Sa i përket fuqisë së akteve ligjore, shumë mirë e ceku këshilltari z.FlakronGashi, pra janë akte nënligjore të bazuara në ligje përkatëse dhe kryesisht nxjerrën për të mundësuar një zbatim më të mirë të ligjit, pra janë një formë e interpretimit të ligjit përkatës. Unë ju ftoj që këtë propozim Rregullore ta miratoni, dhe pastaj bashkërisht ta monitorojmë zbatimin e saj.

Pas votimi u konstatua se njëzëri u miratua propozim Rregullorja për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre.

5. Propozimi i Vendimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e komunës së Podujevës

z.MehmetGashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar dhe e kemi shqyrtuar këtë propozim vendim dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim me një korigjim në çmimore ashtu siç ceket në konstatime, andaj pa dashur të zgjas, fjalën hyrëse ja jap drejtorit të Drejtorisë përkatëse.

z.FaikMuçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, në mbledhjen e KPF-së pothuajse të gjithë jemi pajtuar që duhet të përkrahet ky propozim vendim, por në atë mbledhje ka pas kërkesë dhe është propozuar që në kuadër tëçmimores së këtij propozim vendimi të përfshihet edhe hapja e varrit, kërkesë e cila ndoshta në të ardhmen do të përfshihet mirëpo tani për tani ka mungesë të buxhetit dhe nuk mund të përshihet. Kërkoj nga ju këshilltarët e Kuvendit që ta miratoni këtë propozim vendim duke përfshirë edhe një korigjim të gabimit teknik i cili është edhe rekomandim i KPF-së.

z.MehmetGashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka këshilltarë të lajmëruar për diskutim sepse konsideroj se të gjithë e përkrahni këtë propozim vendim, unë e hedh në votim duke përfshirë edhe rekomandimin nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim vendimi për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e komunës së Podujevës, duke përfshirë edhe rekomandimin nga Komiteti për Politikë dhe Financa përkatësisht në pikën 3 të çmimoreve të ofrimit të shërbimeve të varrimit, të korrigohet si vijon: "dërrasat me të cilat mbulohet kufoma pas lëshimit në varrë, me dimensione gjerësia 200 cm, gjatësia 115 cm dhe trashësia 05 cm.

6. Propozimi i Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Palestrës së Sporteve në Podujevë

z.DurimSalihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit (DPUMM), e paraqiti fjalën hyrëse ku ndër të tjera theksoi, në bazë të kërkesave të mëparshme të Kryetarit të Komunës drejtuar nivelit qendrorë konkretisht Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, për ndërtimin e një palestre të sporteve në qytetin e Podujevës, tash së fundmi ka ardhur njoftimi nga ana e Ministrisë së cekur se janë ndarë mjete buxhetore për ndërtimin e një Palestre të Sporteve në qytetin e Podujevës, mirëpo nga Komuna e Podujevës është kërkuar lokacioni. DPUMM në konsultim me Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë e kemi parë të arsyeshme qëlokacioni për ndërtimin e Palestrës së Sporteve të jetë prona në sipërfaqe prej 2 hektarësh afër Hotel Besianës, përkatësisht në anën e djathtë të rrugës që dërgon në shkollën fillore "XheladinRekalii".

znj.AdelinëStublla, theksoi, sa i përket këtij propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive, do të ishte mirë të ketë diskutim të hapur me qytetarë pasi që këto vendime janë afatgjate. Pikërisht ajo parcelëështë planifikuar më parë për stacion të autobusëve, tani lindë pyetja, me cilën pjesëështë ndërruar dhe ku do të mbetet stacioni i autobusëve. Ne opozita disa seanca më parë kemi kërkuar që të bëhen publike parcelat në pronësi publike në territorin e Komunës tonë dhe të listohen se cilat janë të dhëna me qira, cilat janë të uzurpuara dhe cilat janë të lira, në atë listë nuk bënë pjesë vetëm oborri i fabrikës së ish Fapolit qëështë pronë publike por ka edhe shumë prona të tjera ku gjendja e tyre po mbahet e fshehtë pasi që Komunës apo pushtetit lokal po i konvenon. Pra ne propozojmë që kjo pikë të rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër, respektivisht pas publikimit të listave dhe pas marrjes së mendimeve nga diskutimet publike. Se në cilën parcelë do të ishte më e dobishme vendosja e kësaj parcele, bazuar në materialin që e kemi marrë ditë më parë, e them se nuk do të humbim ndonjëdonacion apo diçka të tillë nëse kjo pikë e rendit të ditës shtyhet, pasi që pas diskutimeve publike do të kenë më shumë ide që janë në të mirë të qytetarëve.

z.AbazLlugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, përgjigje parafolëses, besoj se listën e pronave komunale e posedoni, ndërsa nëse ju jeni në dijeni se ne jemi duke mbajtur prona komunale të fshehta, atëherë duhet të dilni në foltore dhe ta thuani, unë nuk jamë në dijeni se ka prona të fshehta komunale të cilat nuk janë të publikuara, përfshirë këtu edhe ato të cilat janë të dhëna në shfrytëzim dhe për të cilat paguhen qira, po ashtu nuk i fshehim edhe ato prona për të cilat ka borxhe, mirëpo e

përsërisë se asnjë pronë komunale nuk është e fshehur sepse po edhe në rast se ne dëshirojmë ta bëjmë një gjë të tillë atë nuk mund ta bëjmë sepse kopjet e pronave komunale i ka edhe Agjensioni Kadastral i Kosovës si institucion qendrorë që i mirëmban pronat, kështu që e nderuar këshilltare mendoj se i ke ngatërruar pak sa gjërat, ose kërko sqarim ose nëse ju jeni në dijeni për diçka më tepër urdhëro shprehe në foltore

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi, sqarime koleges parafolëse, me Planin Zhvillimorë Urban i cili është miratuar kohë më parë në këtë Kuvend, është planifikuar që ajo pjesë të jetë, hapësirë për kulturë, sport dhe rekreacion, andaj ne jemi bazuar në këtë dhe kemi menduar se sipërfaqja e nevojshme i plotëson kapacitetet që kërkojnë për një palestër sportive, edhe pse në atë pjesë ka edhe sipërfaqe tjera të mjaftueshme për veprimtari tjera e ndoshta edhe për atë që u përmend për stacion të autobusëve.

z.Bahri Selimi, theksoi, sa unë kuptova parcela e caktuar për Palestër të Sporteve është brenda oborrit të ish fapolit, andaj në lidhje me këtë çështje shtroj pyetje apo kërkoj sqarim nga Ekzekutivi i Komunës, sa unë jam në dijeni ajo pronë është në nivel kontesti mes pronës komunale dhe pronës shtetërore në menaxhim të AKP-së, dhe po ashtu sa unë kam njohuri dhe sa jam në dijeni ajo pronë është në ndërtim e sipër ku në atë hapësirë është duke u ndërtuar një fabrikë, gjë për të cilën besoj se jemi në dijeni të gjithë, andaj kërkoj sqarime më të hollësishme rreth kësaj çështjeje dhe a është e drejtë që të ndërtohet një palestër afër një fabrike e cila është prodhuese si dhe a do të ketë ndonjë kontest në të ardhmen që mund të na humb këtë donacion për ndërtimin e palestrës.

z.Abaz Llughaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, përgjigje parafolësit, kurrfarë kontesti nuk mund të ketë sepse prona është komunale ndërsa objektet është fakt që ka qenë një organizatë shoqërore ish fapoli e cila tani është në menaxhimin e AKP-së dhe objektet janë dhënë në shfrytëzim nga ky agjension, ligji për privatizim e thotë që përveç pronave të ish ndërmarrjeve shoqërore nga viti 1989 e këndej të regjistruara në ish odën ekonomike të KSAK-së, Agjensioni Kosovar i Privatizimit ka të drejtë t'i privatizoj ato që i ka në pronësi dhe ato që i ka në posedim, ndërsa parcela në fjalë është rreth 8 hektarë dhe nuk paraqet kurrfarë problemi në zhvillimin e veprimtarisë të objekteve tjera. Në bazë të ligjit për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim dhe këmbimin e tyre, ne i'ukemi bërë kërkesë me të cilën i'u kemi drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencionit Kosovar të Privatizimit (AKP) ku kemi kërkuar tërheqjen e tyre nga privatizimi i asaj pjese, dhe po ashtu disa herë AKP-së i kemi shkruar shkresa dhe është një prej kontesteve që deri tani nuk ka mundur të qitet në privatizim, por deri tani është dhënë vetëm me koncesion ose me qira objekti sepse toka nuk mund të jepet, pra nuk është privatizuar. Nga parcela prej 8 hektarëve është parcelizuar në mënyrë të rregullt, pronë komunale, ku me kërkesë të Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes së Mjedisit, sektori i Gjeodezisë ka dal në terren dhe ka formuar parcelë të re prej 2 hektarë, andaj nuk ka asgjë kontestuese sa i përket kësaj çështjeje.

z.Flakron Gashi, theksoi, mora fjalën me qëllim që të shtroj pyetje drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë i cili me shumë siguri e tha se nuk ka prona publike të uzurpuara dhe të njëjtin qëndrim e ka pas edhe më parë, mirëpo unë mendoj se ka, dhe këtë ju e dini shumë mirë, por ju prisni deri sa uzurpuesit t'ju dalin kundër a pastaj t'ju publikoni se shfrytëzojnë ose kanë të uzurpuar pronën publike.

z.Naim Çunaku, theksoi, kur jemi duke debatuar për lokacionin për ndërtimin e një objekti për sport dhe rekreacion apo Palestrës Sportive, edhe pse shumica prej këshilltarëve janë në dijeni, më duhet ta cekë se ky Kuvend i Komunës më parë ka marrë një Vendim që ajo pronë të kaloj në pronësi Komunale, ku edhe në atë kohë ka pasë kundërshtime nga ana e AKP-së, mirëpo sa unë kam njohuri, atë që edhe drejtori e ceku, objektet të cilat janë nëatëpronë menaxhohen nga AKP-ja ndërsa prona ku janë të ndërtuara objektet është pronë komunale, pra ky Kuvend ka vendos ashtu dhe derisa është ashtu ne sot duhet të jemi ata që duhet të jemi në mbrojtje të pasurisë që do të kenë në shfrytëzim qytetarët e Komunës tonë. Kurse sa i përket dilemës tjetër që po debatohet rreth asaj ka apo nuk prona, është mirë të definohen gjërat sepse janë akuza të rënda, dhe nëse vërtetë është ashtu dikush duhet të jap llogari, më gjerësisht nuk dëshiroj të hy rreth këtij debati, mirëpo qëllimi im është të sqaroj se prona për të cilën jemi duke debatuar dhe për të cilën sot po mendojmë ta destinojmë për ndërtimin e një palestre të sporteve, po e përsërisë se ka një Vendim të Kuvendit sipas të cilit kemi vendos që ajo pronë të jetë pronë komunale dhe ta kemi në shfrytëzim ne.

z.FidanRekaliu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim përkatësisht caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës së Sporteve në qytetin e Podujevës, dhe mendoj se duhet që të gjithë ne t'i përkrahim të gjitha investimet të cilat janë në dobi të qytetarëve të Komunës së Podujevës duke përfshirë edhe ndërtimin e palestrës së sporteve. Sa i përket pronës, unë jam shumë i bindur që Ekzekutivi i Komunës është shumë i sigurtë që prona përkatëse është pronë e Komunës së Podujevës dhe që nuk lejon ndërtimin e një objekti shumë të rëndësishëm dhe me kosto milionëshe në një pronë që nuk është në pronësi komunale, dhe njëkohësisht e falënderoj publikisht Kryetarin e Komunës për sjelljen e investimeve të shumta në Komunën e Podujevës. Pra mendoj se Ekzekutivi i Komunës nuk bie pre e një gjëje të tillë ku lokacioni përkatës mund të mos jetë pronë komunale.

z.RafetLlapashtica, theksoi, sot në rend të ditës kemi propozimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës së Sporteve, gjegjësisht a e përkrah Kuvendi ndërtimin e palestrës apo jo, besoj se të gjithë jemi për ndërtimin e palestrës sepse kemi mungesë të objekteve të tilla. Ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së jemi për investimin në fjalë dhe investime tjera, mirëpo çështja e statusit të pronës mbetet në përgjegjësi të drejtorit të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë (DPKGJ), mendoj se edhe nëse e tërë ajo pronë është në menaxhim të AKP-së ne duhet t'i përdorim të gjitha alternativat në mënyrë që ta kthejmë në pronë komunale dhe për këtë çështje ne si Grup i këshilltarëve jemi që të gjitha pronat publike duke përfshirë edhe ato që janë në menaxhim të AKP-së t'i kthen në pronësi të Kuvendit të Komunës së Podujevës në mënyrë që vetë Kuvendi i Komunës të menaxhoj me ato prona. Pra në parim jemi për ndërtimin e palestrës sportive në parcelën përkatëse, ndërsa problemet me dokumentacionin e pronave përkatësisht parcelës përkatëse është drejtori i DPKGJ i cili ka njohurit e nevojshme dhe nuk do të dëshiroj të debatojmë sot për këtë çështje por të fokusohemi në propozimin konkret që e kemi para vetës, dhe është mirë të mos zgjatet më tutje kjo çështje por të hedhet në votim.

z.HakiRudari, theksoi, zonja AdelinëStublla shumë mirë e ceku se askush nuk jemi kundër investimeve dhe kundër ndërtimeve, përkundrazi jemi për ndërtime dhe investime vërtetë në baza ligjore. Më parë kanë qenë propozime, premtime apo ndoshta kanë qenë vetëm fushatë që në atë lokacion të ndërtohet stacioni i autobusëve, ndërsa tani

premtohet Palestër Sportive, e në të ardhmen mund të ndodh të premtohet ndonjë pishinë olimpike, pra nuk është mirë të bëhen këso lojërash politike. Sa i përket pronave, pikërisht si rezultat i çështjes së pronësisë ka mbetur pa u rregulluar dhe zgjeruar Obelisku i Heroit Afrim Zhitia, dhe për këtëçështje jemi në dijeni të gjithë që ka qenë një investim i Ministrisë së Ambientit, pra nuk duhet pritur situata të ndryshme dhe pastaj të dilet me dokumente duke treguar personat të cilët kanë prona të uzurpuara, por duhet të vlejnjë për të gjithë ne pa dallime dhe kush do qoftë ai person që ka uzurpuar të bëhet publike.

z.KadriAvdiu, theksoi, deri tani dëgjuam diskutime të ndryshme rreth kësaj pike të rendit të ditës, kryesisht ajo që mua më shtyri të marrë fjalën janë diskutimet rreth asaj se a është pronë kontestuese apo nuk është ajo parcelë e cila mendohet të caktohet për ndërtimin e Palestërre Sportive. Kolegu z.NaimÇunaku e ceku dhe ashtu është, që ky Kuvend më parë ka marrë një Vendim qëprona në sipërfaqe prej 8 hektarëve të jetë pronë komunale, dhe është pronë komunale. Shpeshherë ne po vihem në lojëra tëAgjensionit Kosovar të Privatizimit që ka qenë, dhe i cili ka bashkëpunuar me grupe mafioze dhe me grupe kriminale që e kanë shkatërruar edhe ndjenjën e qytetarëve, kurse ne sot këtu mendojmë se a duhet të ndërtohet një Palestër Sportive, e qëështë e vonuar sepse kjo ndodh pas 16 viteve, andaj për këtëçështje ne duhet të jemi njëzëri të gjithë këshilltarët e Kuvendit, dhe nuk e njohim AKP-në, kur është prona e jona dhe është e drejtë e jona, kurse AKP-ja mund të merr vendime në shtëpitë dhe pronat e saj që ka, e jo në prona komunale, prandaj të mos hezitojmë këtu t'i themi disa gjëra. Unë vetëm e kam frikën se a është Ekzekutiv i Komunës në gjendje të respektoj vendimin e Kuvendit, dhe nuk është mirë të diskutojmëpër këtëçështje nga aspekti pozitiv – opozitë, sepse ne jemi këtu për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve dhe të rinjve tanë. Pra të ndalemi dhe të debatojmëkonkret për problemin, në rast se Ministria përkatëse vërtetë ka qëllim dhe vullnet për ndërtimin e asaj palestere ne nuk guxojmë të diskutojmë gjëra të panevojshme, sepse jo vetëm 2 hektarë por krejt prona prej 8 hektarëve është pronë komunale, prandaj ne sot duhet ta mbështesim këtë dhe për këtë nuk ka diskutim, ndërsa AKP-ja të merret me mafi ashtu siçështë marrë deri sot, shpresoj të mos jetë ashtu edhe AKP-ja e tanishme përkatësisht bordi dhe struktura e re, kurse për të kaluarën jemi në dijeni se janë marrë grupe mafioze, po ashtu edhe ata që kanë insistuar për atë pronëjanë grup mafioz të cilët mundohen përmes turshive dhe dallavereve të ndryshme të shesin hekurin dhe pjesë të ndryshme për skrap me 13 cent kg. si qëllim, por këtu dikush qëndron mbrapa dhe ka individë të caktuar të cilët tentojnë të hyjnë në atë pronë me qëllim të përvetësimit tëasaj prone në të ardhmen, por këto gjëra nuk duhet t'i lejojmë ne si Kuvend i Komunës.

z.MirsadKamerolli, theksoi, me të vërtetë pas fjalëve të parafolësit z.KadriAvdiu mendoj se nuk ka vend për fjalë të tjera, sepse e vërteta është ashtu siç ai e potencoi, dhe nuk mund të jetë ndryshe.

z.AbazLlugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, e ndjejë për obligim të jap një sqarim për z.FlakronGashin të cilit po i drejtohem si koleg apo si mik, jo me qëllim të replikës. Problemi është rreth dy termeve të cilat u ceken gjatë diskutimeve të mëparshme me znj.AdelinëStublla, dhe atë, uzurpimi dhe fshehja e parcelave, janë dy terme të ndryshme. Uzurpime nuk pretendoj se nuk kemi, kemi uzurpime si në krejt Kosovën, për pasqyrën e uzurpimeve po nisem nga vetja ku ndoshta gjyshi im ose prindi im kanë qenë uzurpues ku edhe unë pastaj rezultojë si uzurpues,

mirëpo të gjithë ju mund të hyni dhe të shfletoni Gjeoportalin në Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe mund të shihni se ndoshta asnjë nuk jemi krejtësisht të kursyer prej uzurpimeve, nuk them absolut por shumica po. Pra ishte një akuzë se gjoja ne i kemi fshehur ato prona, përndryshe e dimë se kemi prona të uzurpuara edhe në mes të qytetit, ndërsa sa i përket çështjes që u përmend rreth Obeliskut të Heroit Afrim Zhitia, nuk është lënë ajo çështje për shkak të pronës por ka qenë në procedurë gjyqësore, dhe ata persona nuk i kemi kursyer por i kemi shpallur uzurpatorënë procedurën administrative. Sa i përket lokacionit për të cilin jemi duke debatuar sot dhe për të cilin u tha se ka qenë e paraparë që në atë parcelë të ndërtohet stacioni i autobusëve ndërsa tani e njëjta parashihet për ndërtimin e Palestrës së Sporteve, kjo çështje ka ndodhur për shkak se ne kur kemi bërë kërkesë Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Agjencionit Kosovar të Privatizimit që atë pronë të mos e privatizoj është dashur që të japim njëarsyeshmëri të pronave ku kemi kërkuar që parcelat e pronave shoqërore, tokat bujqësore dhe ato të kooperativave të mos qiten në privatizim ku edhe është dashur të bëhen arsyetime konkrete, kurse për parcelën në fjalë kemi paraparë të ndërtohet stacioni i autobusëve, mirëpo nuk kemi qenë në dijeni se një ditë do ta kemi donacion ndërtimin e një Palestre Sportive, pra kjo është sqarimi.

z.Flakron Gashi, theksoi, unë e vlerësoj shumë dhe më vie shumë mirë që pas 16 viteve një drejtor komunal e pranon se në qendër të qytetit ka prona të uzurpuara, kjo është shumë me rëndësi. Unë mendoj se ka dy lloje të uzurpimeve, në mënyrë të pavetëdijshme dhe në mënyrë të vetëdijshme të organizuar, ato të cilat drejtori parafolës i përmendi të stërgjysheve dhe prej kohës kur kemi qenë nën perandorinë osmane dhe pastaj serbisë janë probleme në vete, mirëpo nëse pronat në qytet janë uzurpuar në bashkëpunim me zyrtar komunal kjo është diçka tjetër, dhe nëse ju drejtor jeni në dijeni se ka prona të uzurpuara në qytet, dhe vjen koha ta pranoni vetëm pas një debati që ngritët në Kuvend nga ana e këshilltarëve, atëherë ndërmerrni masa sepse ka ligje sipas të cilëve duhet të mbrohet prona komunale.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se ne jemi përfaqësues të qytetarëve dhe duhet të mbrojmë interesat e qytetarëve, është ofruar një donacion për ndërtimin e një Palestre të Sporteve, kurse ne duhet të ndajmë lokacion, parcela e propozuar është pronë komunale dhe me Plan Zhvillimorë Urban është e paraparë që në atë pjesë të ndërtohet qendër sportive-rekreative, andaj pa dashur të zgjasë, e hedh në votim këtë propozim vendim.

Pas votimit u konstatua se me 31 vota për, 2 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, u miratua propozimi i vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Palestrës së Sporteve në Podujevë.

7. Propozimi i Vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesave të Abdurrahman Ismajl Gërguri nga fshati Siboc i Epërm, Zekë Muharrem Nuredini nga fshati Siboc i Epërm dhe sipas kërkesës së “HibPetroli” sh.p.k. me pronar Ibrahim Bucaliu nga Ferizaj)

Pas votimit u konstatua se njëzëri, në pako, u miratuan propozim vendimet, si vijon;

-Propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së Abdurrahman Ismajl Gërguri nga fshati Siboc i Epërm.

-Propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së Zekë Muharrem Nuredini nga fshati Siboc i Epërm, dhe

-Propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së "Hib Petrol" sh.p.k. me pronar Ibrahim Bucaliu nga Ferizaj.

8. Të Ndryshme

z.Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi, ju njoftoj se rreth emërimit të rrugëve përkatësisht shenjëzimit të rrugëve me vendosje të tabelave të emrave, javën e kaluar ka ardhur një njoftim zyrtar nga Agjensioni Kadastral i Kosovës dhe Unioni Evropian se është bërë tenderimi ku është e përfshirë edhe Komuna e Podujevës, përfituese është një kompani nga Gjilani, dhe vetëm pritët të nënshkruhet memorandumi i bashkëpunimit dhe vendosja e tabelave të rrugëve do të implementohet këtë vit.

z.Flakron Gashi, theksoi, pyetje për drejtorin z.Avni Fetahu, meqë u cek më parë edhe çështja e zhvillimit ekonomik lokal dhe jemi në dijeni se jemi në sezonin e pranverës, deri ku ka shkuar përzgjedhja dhe kur do të publikohet lista e përfituesve të subvencioneve të mjedrave. Jemi në dijeni se aplikimet janë në numër të madh ndërsa mundësit do të jenë shumë të vogla, dhe njëfarë mënyre aplikuesit janë duke pritur përgjigjen nga Komuna ku edhe mund t'ju humb një sezon sepse mundësit për t'i subvencionuar të gjithë nuk janë, dhe a ka mundësi që po sa të bëhet përzgjedhja e përfituesve ajo listë të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komunës ngase deri tani nuk ka ndodhur një praktik e tillë, dhe nuk e di pse fshehet.

z.Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, nuk dëshiroj të hapë debat por të jetë vetëm njoftim, edhe pse nuk kaloj si pikë shtesë për këtë mbledhje çështja rreth ekskursioneve. Në bazë të Udhëzimit Administrativ 02/2016 të ashtuquajturat ekskursione janë ilegale dhe nuk është pjesëmarrëse dhe as organizatore Drejtoria e Arsimit, as shkollat përkatëse si dhe as mësimdhënësit. Është ilegale sepse ekskursionet e tilla organizohen nga nxënësit por me iniciativë nga dikush nga jashtë, ndërsa ne si Drejtori i kemi marrë të gjitha masat në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspeksionit dhe me Policinë ku jemi duke punuar që 2 ditë që këtë lloj tradite, ashtu po e quaj, të organizimeve të tilla do të bëjmë përpjekje të mos i lejojmë. Shqetësimi është se informacionet i kemi siguruar prej prindërve të nxënësve, mirëpo mbetet të shihet se sa janë të gatshëm tani prindërit të bashkëpunojnë me shkollën përkatëse në rend të parë dhe me Drejtorinë e Arsimit, që të na ndihmojnë në mënyrë që të mos kemi fare nevojë të ballafaqohemi me Polici dhe organe tjera për të pamundësuar një ekskursion të tillë e që besoj se do të arrijmë të paktën zvogëlimin e numrit të tyre.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sqarim rreth pyetjes së z.Lutfi Rexhepit i cili në fillim të mbledhjes shtroj pyetje, në mbledhjen e kaluar ne u morëm vesh që të ulemi shëfat e Grupeve të këshilltarëve dhe të përgatisim një deklaratë rreth çështjes së ngritur për pagat e këshilltarëve të Kuvendit. Meqë për këtë çështje ishin marrë edhe televizionet por edhe gazeta ditore dhe ne disa prej Grupeve të këshilltarëve i kemi dhenë deklaratat rreth kësaj çështjeje, andaj mendoj se në një formë kjo çështje e ka arritur efektin dhe publiku është i informuar për këtë çështje.

Nuk pati këshilltarë tjerëtë lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën12;10

**Procesverbalin e mbajti
EnisSheholli**

Nr. 01-006-36570

**Podujevë,
29 prill2016**

MehmetGashi

Kryesuesi i Kuvendit